

A ju garantohet mbrojtje sinjalizuesve?

Personat që sinjalizojnë janë plotësisht të mbrojtur dhe nuk mund të jenë subjekte të përgjegjësisë penale ose civile apo procedurave disiplinore për shkak të sinjalizimit të tyre. Sinjalizuesi mbrohet nga çdo veprim i dëmshëm i marrë ndaj tij nga punëdhënësi për shkak të sinjalizimit, duke përfshirë:

- shkarkimin nga puna;
- pezullimin nga puna;
- transferimin brenda ose jashtë subjektit privat pa pëlqimin e tij;
- uljen në pozitë;
- zvogëlimin e pagesës;
- humbjen e statusit dhe privilegjeve;
- mos ngritjen në pozitë;
- heqjen e të drejtës për të marrë pjesë në trajnime;
- vlerësime negative në marrëdhënien e punës;
- anulimin e një licence ose leje;
- përfundimin e një kontrate për mallra apo shërbime;
- veprime të tjera të dëmshme në lidhje me marrëdhënien e punës.



Në rastet kur sinjalizuesi i është nënshtruar ndonjë veprimi të dëmshëm në vendin e punës, mund të drejtohet për dëmshpërblim tek Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil në gjykatën ku ndodhet selia e punëdhënësit, apo ku sinjalizuesi e ka vendbanimin.

**JU JENI TË MBROJTUR, PRANDAJ
SINJALIZONI ME GUXIM!**



SINJALIZO, REAGO, NDRYSHO!



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA


FOL

Çka është sinjalizimi?

Sinjalizimi është raportimi i parregullsisve, shkeljeve, keqpërdorimeve ose cenimit të interesit publik në ambientin e punës, pavarësisht se a bëhet fjalë për sektorin publik apo privat.

Të punësuarit raportimet mbi shkeljet apo keqpërdorimet në vendin e punës duhet t'i bëjnë tek personi përgjegjës për sinjalizim dhe atë mund t'a bëjnë me shkrim, me postë apo e-mail, si dhe gojarisht. Çdo punëdhënës privat që ka më shumë se 50 të punësuar është i obliguar të caktoj personin përgjegjës për sinjalizim, i cili është përgjegjës për ta pranuar dhe trajtuar rastet e sinjalizimit.

Pse duhet të sinjalizoj?



Duke i raportuar keqpërdorimet dhe parregullsitë, sinjalizuesit ndihmojnë në zbulimin e veprimeve që dëmtojnë interesin publik, sigurinë, integritetin financiar dhe sundimin e ligjit. Ata luajnë një rol kyç në shpërndarjen e informacioneve të rëndësishme dhe në ngritjen e vetëdijes së publikut rreth abuzimeve të mundshme.

Në anën tjetër, sinjalizimi në sektorin privat mund të kontribuojë në ndërgjegjësimin e punonjësve dhe menaxherëve rreth rregullave, standardeve etike dhe ligjeve që duhet të ndjekin. Ky proces i ndërgjegjësimit ndikon në kulturën dhe ndërgjegjësimin e përgjithshëm të bizneseve për praktikatat e ndershme.



Duke i raportuar keqpërdorimet dhe parregullsitë, sinjalizuesit ndihmojnë në zbulimin e veprimeve që dëmtojnë interesin publik, sigurinë, integritetin financiar dhe sundimin e ligjit.

Kush përfshihet në sektorin privat?

Sektori privat përbehet nga të gjitha subjektet juridike që nuk bëjnë pjesë në sektorin publik. Sipas legjislacionit, ky sektor përfshin:

- shoqëritë tregtare
- organizatat joqeveritare
- çdo organizatë tjetër e themeluar në bazë të ligjit.

Cilat janë llojet e sinjalizimit në sektorin privat?



I brendshëm

(informacioni raportohet tek zyrtari përgjegjës për sinjalizim brenda institucionit);



I jashtëm

(informacioni raportohet tek institucionet kompetente për fushat përkatëse);



Publik

(informacioni shpaloset në media, tek organizatat joqeveritare, përmes internetit, në mbledhje publike, ose në ndonjë mënyrë tjetër që e bën informacionin publik).

Cilat gjopa mund të ju shqiptohen bizneseve, në rast se nuk zbatojnë ligjin?

Ligji parasheh gjopa prej 500 euro deri në 20.000 euro për subjektet private të cilat:

- nuk caktojnë zyrtarët përgjegjës për sinjalizim;
- nuk mbrojnë sinjalizuesin nga veprimet e dëmshme;
- nuk njoftojnë me shkrim të gjithë të punësuarit, lidhur me të drejtat që u'a njih ligji;
- nuk ndërmarrin veprime pas raportimit të informacionit brenda afatit të përcaktuar;
- nuk informojnë sinjalizuesit për rezultatet e procedurës;
- pengojnë sinjalizimin;
- zyrtarët përgjegjës nuk ruajnë informacionet në mënyrë konfidenciale.

